



BASHKIM FAMILJAR

Kosovo

01.10.2023

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen personalisht për bashkim familjar në Zvicër

- 3 formularë të plotësuar dhe të nënshkruar [formular kërkesë për vizë afatgjatë](#) (Visum D)
- 4 Foto pasaporte
- Pasaporta origjinale + 4 kopje të pasaportës (vetëm faqja me foto)
- origjinali i «**Certifikatë e vendbanimit**» aktual, me vulë apostile + 1 kopje
- origjinali i «**Vërtetim nga Arkivi**» aktual, me vulë apostile dhe përkthim (përkthimi në një gjuhë zyrtare të Zvicrës ose në gjuhën angleze) + 1 Kopje
- Dëshmia aktuale që nuk jeni nën hetime e lëshuar nga Gjykata « **Certifikatë mbi dënimet penale** » (shih platformën shtetërore E-Kosova), me përkthim + 1 kopje

Dokumentet e mëposhtme nga personi me banim në Zvicër:

- 4 kopje të pasaportës
- 4 kopje të lejes së qëndrimit të në Zvicër

Dokumentet shtesë (jo më të vjetër se 6 muaj) kërkohen në rastet e mëposhtme

A) Çiftet bashkëshortore

- «**Certifikatë e martesës**», me vulë Apostile + 1 kopje

Nëse martesa është lidhur pa certifikatën e kapacitetit martesor

- «**Certifikatë e lindjes**», me vulë apostile + 1 kopje
(për të lindurit jashtë vendit: certifikata origjinale e lindjes e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e vendit të lindjes + 1 kopje)
- Në rast të ndryshimit të emrit/mbiemrit: «**Vendimi për ndryshimin e emrit/mbiemrit**» me shënim rreth plotfuqishmërisë, me vulë apostile dhe përkthim + 1 kopje
- Për personat e shkurorëzuar: «**Kopje e vendimit të shkurorëzimit**» me shënim rreth plotfuqishmërisë» me vulë Apostile dhe përkthim + 1 kopje
- Për personat e ve: «**Certifikatë e vdekjes**» me vulë apostile + 1 kopje

B) Fëmijët që bashkohen me njërin prind

- «**Certifikatë e lindjes**» me vulë Apostile + 1 kopje
(për të lindurit jashtë vendit: certifikata origjinale e lindjes e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e vendit të lindjes + 1 kopje)
- «**Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile**», me vulë apostile + 1 kopje

Nëse prindërit jetojnë të ndarë:

- Nëse njëri prind jeton në Kosovë, ai duhet të paraqitet personalisht në sportel dhe të jap pëlqimin me shkrim. Deklarata prej gjykatës ose noterit nuk do të pranohet.
- Nëse njëri prind jeton jashtë vendit: kopje e lejes së qëndrimit dhe një deklaratë pëlqimi e vërtetuar nga një noter nga vendi ku jeton me përkthim + 1 kopje

C) Prindërit të cilët bashkohen me fëmijët e tyre duhet të aplikojnë për **leje qëndrimi pa të drejtë pune**. Dokumentet e mëposhtme duhet të dorëzohen.

- Të gjitha dokumentet e listuar tek «**Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen personalisht për bashkim familjar në Zvicër**»
- «**Certifikata origjinale e lindjes së fëmijës**» (e lëshuar nga vendi i lindjes: me vulë apostile dhe përkthim + 1 kopje)
- Për personat e ve: «**Certifikatë e vdekjes**» me vulë apostile + 1 kopje
- Vërtetim të mbështetjes financiare nga pjesëtarët e familjes ose nga ata me të cilët do të jetoni

Dokumentet e gjendjes civile dhe vula apostile

Dokumentet origjinale janë të destinuara për autoritetin kompetent në Zvicër dhe nuk kthehen.

Përkthimet duhet të jenë në një gjuhë zyrtare të Zvicrës ose në gjuhën angleze

Vulat apostile mund të merren në zyrat në vijim:

Dokumentet e gjendjes civile:

Ministria e Punëve të Brendshme,
Sektori për Regjistrim dhe Status Civil
Agjencioni për Regjistrimin e Qytetarëve
Luan Haradinaj
10000 Pristina

Aktgjykime ose vendime gjyqësore:

Ministria e Punëve të Jashtme
Ndërtesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme
Luan Haradinaj
10000 Pristina

Pagesa

Të rriturit 80 €

fëmijët 6-12 vjeç 40 €

Të liruar nga pagesa: Anëtarët e familjeve të shtetasve zviceran dhe shtetasve të EU/EFTA ose fëmijët nën moshën 6 vjeçare

Pagesa mund të bëhet me Visa/Mastercard ose me para në dorë, nuk pranohen kartëmonedha më të mëdha se 50 €

Caktimi i terminit

Termi do të caktohet vetëm kur të kemi marrë konfirmimin me shkrim se ju keni në posedim të gjitha dokumentet sipas kësaj fletë informacioni. Më pas mund të kërkonti një termin duke plotësuar [formularin e kontaktit](#) në faqen tonë të internetit:

<https://www.eda.admin.ch/countries/kosovo/en/home/etc/kontaktform-langfristige-visa.html>



Njoftim

Ambasada Zvicerane rezervon të drejtën të kërkojë dokumente dhe/ose informacion shtesë.

Aplikimi do t'i dërgohet zyrës kompetente të migracionit kantonal për një vendim. Procedura mund të zgjasë shumë. Për informacion mbi ecurinë e dosjes, ju lutemi kontaktoni [Autoritetet kantonale të migracionit dhe punësimit](#).

Sapo të merrni autorizimin nga Zyra e Migracionit, plotësoni [formularin e kontaktit](#) në faqen tonë të internetit dhe ngarkoni një kopje të autorizimit si dhe pasaportën e aplikuesit, në mënyrë që të caktoni një termin për dhënien e vizës:

<https://www.eda.admin.ch/countries/kosovo/en/home/etc/kontaktform-langfristige-visa.html>

